



Pranuar / Dostignut Punëshet/Prisuto Received/Deliverty		12.10.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Nr Prot Prot No	Shitja e Printog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKMBASHK	6127/2022		119	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.724/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.724/2022 të datës 22.08.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë kundër organit të punësimit/Komuna e Pejës, në çështjen juridike “shkelje e të drejtës në pagë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 12.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.724/2022 e datës 22.08.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Obligohet Kryetari i Komunës së Pejës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi të inicioj veprimet e nevojshme ligjore për harmonizimin e koeficientit të pagës, nga koeficienti shtatë pikë pesë (7.5) në koeficientin tetë pikë pesë (8.5) për nëpunësin civil Arinait Demaj.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Pejës, më datë 22.08.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 4867/2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.724/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër njoftimit të datës 11.08.2022 të Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Pejës, me te cilin i është refuzuar kërkesa për harmonizimin e koeficientit të pagës me titullin e punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 25.08.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Pejës, ndërsa më datë 02.09.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më Vendimin VK.nr.108/2022 të datës 04.10.2022 ka shtyrë afatin për vendosje edhe për dhjetë (10) ditë pune për shkak të kompleksitetit të çështjes dhe nevojës për shqyrtim të mëtutjeshëm të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 4867/2022 të datës 22.08.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 11.08.2022 nga Udhëheqësi i Personelit i Komunës së Pejës për ankuesin; Emailin e ankuesit të datës 22.08.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 25.08.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 02.09.2022; Akt Emërimin datës 04.01.2012 për ankuesin; Konkurs intern për Shef i Zyrës së Informimit; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 09.10.2013; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Shef i Zyrës së Informimit; Aktvendimin me Nr. 02-112-5345/2013 i datës 25.07.2013; Akt Emërimin për pozitë Shef i Sektorit për Financa; Akt Emërimin për pozitën Udhëheqës i Njesisë Ligjoroteknike dhe për leje ndërtimit; Akt Emërimin për pozitën Udhëheqës i Njesisë për Mbrojtjen e Mjedisit; Akt Emërimin për pozitën Udhëheqës i Njesisë për kushte të lokacionit dhe leje urbane; Akt Emërimin për pozitë Shef i Sektorit për Inspektim Komunal; Akt Emërimin për pozitë Shef i Sektorit për Shërbime Publike; Akt Emetimin për pozitën Shef i Sektorit për Kërkim Shpëtim; Akt Emërimin për pozitën Shef i Zyrës Ligjore; Akt emërimin për pozitë Shef i Zyrës Komunale të Gjendjes Civile; Akt Emërimin për pozitën Shef i Sektorit Teknik; Akt Emërimin për pozitën Shef i Sektorit për Rini; Akt Emërimin për pozitën Shef i Sektorit për Kulturë; Akt Emërimin për pozitën Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Sociale; Akt Emërimin për pozitë Shef i Sektorit për Bujqësi; Akt Emërimin për pozitë Drejtor për Mirëqenie Sociale; Akt Emërimin për Udhëheqës i Sektorit për Inspektime; Akt Emetimin për pozitën Udhëheqës i Sektorit për Mirëqenie Sociale; Akt Emërimin për pozitë Udhëheqës i Sektorit për Planifikime Strategjike; Kërkesën e datës 19.09.2022 për Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë-MPB; Përgjigjen e datës 30.09.2022 nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë-MPB dhe kërkesën e datës 03.10.2022 për Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë-MPB; Vendimin VK.nr.108/2022 të datës 04.10.2022 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është pjesërisht e bazuar, sepse:

Kolegji i Këshillit nga administrimi i provave të lëndës ka gjetur se ankuesit sipas Akt Emërimit të datës 09.10.2013 është i punësuar në pozitë e punës *Shef i Zyrës për Informim* në Komunën e Pejës dhe realizon pagën me koeficient shtatë pikë pesë (7.5).

I njëjti me datë 28.07.2022 ka parashtruar kërkesë për rregullimin e koeficientit të pagës me titullin e punës, ndërsa udhëheqësi i personelit pranë organit përkatës të punësimit më datë 11.08.2022 ka refuzuar kërkesën e ankuesit duke e njoftuar ankuesin se të gjithë udhëheqësit e sektorëve paguhën sipas koeficientit të pagës shtatë pikë pesë (7.5).

I pakënaqur me përgjigjen e organit të punësimit, ankuesi me datë 22.08.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për njohjen e të drejtës për harmonizimin e koeficientit të pagës me titullin e punës, sepse sipas të njëjtit për titullin e njëjtë të punës në institucionet tjera publike, nëpunësit civil paguhen me koeficient të pagës nëntë pikë pesë (9.5).

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në dispozitat e nenit 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, më datë 19.09.2022 dhe 03.10.2022 i është drejtuar me shkresë Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, si organ përgjegjës për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave për pagat e zyrtarëve publikë dhe funksionarëve publikë, duke kërkuar informacione në lidhje me koeficientin e pagës për titullin e punës *Shefi Zyrës për Informim* të cilën pozite e mban ankuesi. Kjo e fundit duke u përgjigjur në kërkesë, më datë 04.10.2022 ka njoftuar se në bazë të Shtojcës Nr.1/7 të Rregullores (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, kjo pozitë është e barasvlershme me Udhëheqësin e Divizionit (Sektorin) në Agjenci Ekzekutive dhe se edhe katalogu i vendeve të punës ka përcaktuar pozitën Udhëheqës i Sektorit...Drejtues i Ulët 2, koeficienti i pagës është 8.5.

Kolegji i Këshillit, po ashtu, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit ka analizuar edhe provat tjera materiale të lëndës, respektivisht shkresën me numër DASHC/MAP-04/1571 02/ZPS/3851 të datës 10.11.2014 të lëshuar nga Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil/MAP, përmes të cilës shkresë DASHC kishte kërkuar nga udhëheqësit e organizatave buxhetore që të harmonizohet koeficienti i pagës për disa pozita të punës, ku ndër të tjera është kërkuar që koeficienti i pagës për pozitën e punës *Udhëheqës i Sektorit* të vendoset koeficienti i pagës tetë pikë pesë (8.5).

Andaj, duke marr parasysh konstatimin se ankuesi mban pozitën e punës *Shefi Zyrës për Informim*, pozitë kjo ekuivalente me pozitën e *Udhëheqësit të Sektorit*, për të cilat pozita organi përgjegjës për administrimin e Shërbimit Civil (DASHC) kishte vendosur koeficientin e pagës tetë pikë pesë (8.5), dhe në kuptim të dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 19 ku përcaktohet se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave*, dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 3 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: *1. E drejta e nëpunësve civil për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara më këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil. 2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë....*, Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimi ankimor i ankuesi për harmonizimin e koeficientit të pagës me titullin e punës, gjegjësisht harmonizimin e koeficientit të pagës nga shtatë pikë pesë (7.5) në tetë pikë pesë (8.5) është i drejtë dhe i ligjshëm.

Kështu që duke u bazuar në dispozitat ligjore të sipër cekura dhe më qellim të respektimit të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, Kolegji i Këshillit konstaton se në këtë çështje administrative janë përmbushur kushtet ligjore për aprovimin e pjesëm të ankesës duke i dhënë të drejtë ankuesit për rregullimin e koeficientit të pagës nga shtatë pikë pesë (7.5), në tetë pikë pesë (8.5), për pozitën e punës *Shefi Zyrës për Informim*.



Ndërsa nga provat e administruara të lëndës është konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit për vendosjen e koeficientit të pagës nëntë pikë pesë (9.5) nuk ka mbështetje në aktet ligjore dhe nënligjore me të cilat rregullohet çështja e pagave të zyrtarëve publikë, ashtu sikurse nuk ka mbështetje as në politikat e nënshkruara nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë, si organ përgjegjës për administrimin e Shërbimit Civil në Republikën e Kosovës, kështu që vendosi për refuzimin e këtij pretendimi ankimor si të pa bazuar.

Andaj, për sa me sipër dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër **A.nr.724/2022**

Avdyll BEKTESHI

Procesmbajtës



Jeton KOCA

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Pejës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Pejës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

